



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 17, pika **b** të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 11, paragrafi 1, pika 1.15, nenit 17, paragrafi 5 dhe neneve 20 dhe 26 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, nenit 7, paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ nr. 05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe Parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit administrativ, nr.04/2018, për transparencë në komuna dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2019, merr këtë

V E N D I M
PËR LËNIE NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKTDOKUMENTIT TË PLANIT
RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN E LAGJES "KALABRIA" – PJESA E
KOLEKTORIT, 2019 - 2027

Neni 1
Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

- 1.1. **MIRATOHET** Vendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria" – pjesa e kolektorit, 2019 – 2027.
- 1.2. Projektdokumentit nga pika 1 e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2
Konsultimet publike

- 2.1. Projektdokumentit i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- 2.2. Organizimin e diskutimit publik të projektdokumentit do ta bëjë Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.
- 2.3. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projektdokumentit, së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik – raportin, do t'i dorëzohen Kuvendit të Komunës së Prishtinës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Neni 3
Subjekti përgjegjës

- 4.1. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimi Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- 4.2. Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij projektdokumenti nga përgjegjësitë e tyre të parapara.

Neni 4
Kufiri i territorit

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm, gjendet në lagjen “Mati 1”, përkatësisht në kufirin me Planin rregullues urban “Prishtina e Re” – Zona përfundimtare dhe përfshinë një sipërfaqe prej $S = 8.93$ Ha, ku parcelat kadastrale që shtrihen brenda kufirit të hapësirës që trajtohet janë:

ZK, Prishtinë: 2857-0, 2859-1, 2859-2, 2859-3, 7637-3, 7639-18, 7639-20, 10080-7, 7642-5, 7643-0, 7644-0, 10105-3, 2851-5, 2851-6, 2851-1, 2851-7, 1850-1, 7640-0, 7762-2, 7775-0, 2855-22, 2855-23, 7639-12, 7639-9, 7639-6, 7639-5, 10212-0, 10080-6, 2855-29, 10158-1.

Parcelat ku shtrihet ky plan kanë pronësi private dhe komunale, dhe gjenden në Zonën kadastrale Prishtinë.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-239424/19, më 30.09.2019

KRYESUESI TË KUVENDIT
Agim Kuleta

